REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 136/17
Datë/Datum 27.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 136/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Medical Group" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me barna nga lista esenciale" Lot 24, me numër të prokurimit 206/17/086/111. iniciuar nga AK-/Ministria e Shëndetësisë/ më datën 16.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** , si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Medical Group" - Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me barna nga lista esenciale" Lot 24", me numër të prok 206/17/086/111. iniciuar nga Autoriteti Kontraktues / Ministria e Shëndetësisë /.

II. **Anulohet** vendimi për dhënie të kontratës i AK-/ Ministria e Shëndetësisë /, lidhur me aktivitetin të prokurimit "Furnizim me barna nga lista esenciale" Lot 24", me numër të prok 206/17/086/111 dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Medikal Group" - Prishtinë, aprovohet si e bazuar i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:04.01.2017

Hapja e ofertave është bërë me dt:31.01.2017, ku kanë marr pjesë tre operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me ketë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:21.04.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Liri Med".

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "Medical Group" - Prishtinë me dt: 27.04.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 03.05.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, "Medikal Group" – Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues "Medical Group" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 11 maj 2017 me nr. 136/17 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me barna nga lista esenciale" Lot 24", me numër të prok. 206/17/086/111, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "Ministria e Shendetesise" duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 6, 7, 26, 27, 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
- Po ashtu Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 59, 69 të Ligjit për Prokurimin Publik

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 24.05.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues si dhe ekspertin Teknik, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 05.06.2017 bazuar në sqarimet e cekura në raport konstaton se Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me barna nga lista esenciale" Lot 24", me numër të prok 206/17/086/111, i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovoj vendimin e AK-së, njoftimin për dhënie të kontratës, ndërsa ankesa e OE "Medical Group", të Refuzohet si e pabazuar.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 06.06.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues me datë: 07.06.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12. 06. 2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti i OSHP-së, Vëzhgues nga OJQ "D Plus", u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues: "Medical Group" z.Ramaj deklaroj: Produkti i tenderuar është Heparinë me peshë të vogël molekoulare, është pjesë e listës esenciale, dhe përdoret për ndalimin e koagulimit të gjakut. Jepet në rastet e infarktit të Miokardit, ju jepet pacientëve para se te hyjnë në operim për mos koagulim te gjakut, dhe personave që kanë lëvizshmëri të vogël. Është produkt me rëndësi të madhe.

Çka ka bërë AK-MSH është se ka eliminuar kompaninë më të madhe në Bote Pheize që e ka zbuluar këtë produkt dhe e ka më të avancuarin në treg, dhe ja ka dhënë për 600.000 € çmim më shtrenjtë një kompanie Kineze që e ka kopjuar patentën që i ka skaduar Pheizer-it para 30 viteve. Kjo duke shpik kërkesa që nuk janë në dosje të tenderit.

Për të thjeshtuar më shumë, nëse kërkohet të blihet një Iphone, dhe Pheizer ofron Iphone 7, kompania kineze ka ofruar Iphone 1 me patentë që i ka skaduar Iphone para disa kohe, dhe AK thotë ju keni ofruar sipas dosjes së tenderit, mirëpo ne kemi kërkuar Iphone pak më të trash" që nuk ka kurrfarë lidhje mjekësore. Ky produkt është i listës esenciale, në pikën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit përcaktohet që kriter ka me qenë doza e produktit, sikurse shkruan në Autorizim marketing. Doza e kërkuar ka qenë prej 2000 njësi ndërkombëtare deri në 6000 njësi ndërkombëtare.

Çka ka ndodh, AK thotë dozën e keni në rregull se keni ofruar 2500 njësi ndërkombëtare, mirëpo volumi ne e dojmë 0.4 dhe jo 02.

Do thotë më thjeshtë dhe ai shkruan paracetamol 500mlg, AK thotë këtë 500mlg e dua kokërr më të madhe edhe pse doza është e njëjtë.

Në ekspertizë, po edhe kërkesa e AK thonë se ka qenë kërkesë e QKU-së të jetë vetëm 0.4 volumi.

Kjo nuk është e vërtetë dhe i deponojmë dy prova për të vërtetuar këtë.

Prova parë, kur është bërë lista komunikimi në mes të barnatores qendrore dhe drejtorit të QKU askund nuk përmendet volumi.

E dyta i kemi kërkuar sqarim me shkrim doktorit Islam Krasniqi që është udhëheqës i Klinikës që përdor më së shumti këtë produkt. Të dytë thonë se kurrë nuk është kërkuar volumi, është kërkuar vetëm doza.

Kriteret e listës esenciale nuk janë të ndryshueshme, kjo listë ka qenë edhe më herët, dhe tani pyetja që bëhet është ç'far doze është dërguar më herët me njëjtin specifikacion.

Unë dorëzoj një mostër te viteve të fundit çdo here është dërguar me 0.2ml volum, dhe për herë të parë AK thonë tani se nuk kanë marr kurrë 0.2ml. Ky është produkt Clecane i cili dërgohet edhe tani me kontratë në QKU.

Me të njëjtin specifikacion e kanë pranuar volumin 0.2 ndërsa hera parë tani thonë se nuk bën. Ekspertiza nuk i përgjigjet pyetjes kryesore për eliminim. Doza prej 2500 që është ofruar prej Medical Group a është në përputhje me kërkesat e dosjes prej 2000 deri 6000 njësi.

Në konstatimin e tretë ata thonë që konkurrentët kanë ofruar me 4000 njësi ndërkombëtare andaj janë dy here më të mirë se ju, dhe thonë nëse ke 4000 e më tepër gjithsesi ke volumin 0.4.Sa për inspektim po ja u ofroj si mostër dozën prej 5000 njësi IU dhe prapë ka volumin 0.2ml. Eksperti në konstatimin tjetër thotë se doza prej 4000 njësi është më e favorshme. Me protokolle mjekësore, sipas shkresës që kemi marr direkt prej prodhuesit Pheiser ka raste të ndjeshme kur nuk mundësh fare ti japësh dozën 4000 njësi. Si shembull kur ka infarkt duhet ti jepet 120 njësi here pesha e trupit. Nëse rast proteze në kuk, maksimumi është 2500 njësi dy orë para operimit. Si mundet të dozohen këta pacient më 4000 njësi. Për të treguar rëndësinë e volumit që AK pretendon, dokumentet kliniciste prej prodhuesit, volumi 0.2 dhe 0.4 është vetëm ujë i injeksionit dhe sodium klorit ku tretet doza.

Përfundimisht, AK ka eliminuar prodhuesin më të madh në botë me produktin më premium, dhe i ka dhënë një kopjuesi Kinez që është 30 vite mbrapa me e produktin tonë, ndërsa gjithkund në botë kërkojnë produktin e Phesier. Produkti Kinez është 1,026.000€, ndërsa prudukti i Pheiser 399.000€.

Ky është dallimi për 630.000€ diferencë mes kopanisë që ka zbuluarin ilaçin dhe kopjuesit. Çmimi për njësi që ka ofruar prodhuesi Kinez është 3.83€ për copë, në cilëndo barnatore në Prishtinë gjendet me gjysmën e këtij çmimi. Ndërsa Pheiser e ka tri here më të lirë këtë produkt.

Me këtë çmim tejkalohet edhe mjetet e ndara nga AK, sepse prej 2 milion që është vlera për 56 lote, vetëm për këtë lot harxhohen 1 milion. Me buxhetin e QKU për një vit janë 210.000€ të ndara për këtë produkt, pjesa tjetër e buxhetit janë për lote tjera.

E keni edhe konstatimin e mjekut kryesor që volumi nuk ka kurrfarë rëndësie kur është doza në rregull prej njësisë kërkuese.

E keni dozën e kompanisë që ka zbuluar dhe avancuar këtë produkt në gjendjen ku është në përputhje me dosjen e tenderit.

Ndërsa AK po shton kritere të paqena lidhur me volumin për ti dhënë tenderin një kompanie Kinez\e 630.000€ më e shtrenjtë e që është kopjues i patentit të Pheiser para 30 viteve.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-MSH z.Bajraktari deklaroi: Pajtohemi me konstatimet e ekspertit shqyrtues dhe nuk pajtohemi me pretendimet e OE se thotë kemi shpikur kërkesa. Kërkesa është bërë sipas njësisë kërkuese dhe listës esenciale.

Tenderi është vlerësuar sipas kërkesës së njësisë kërkuese dhe dosjes së tenderit dhe nuk ka as as ndërrim as shpifje. Pretendimi se thotë është tejkaluar buxheti, buxheti nuk ka qenë i ndarë dhe 2 milion janë për komplet tenderin. Qëndron fakti se më herët është furnizuar me 0.2, ndërsa në pyetje përgjigje të OE-ve është thëne se duhet 0.4.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësueses së AK znj.Pllana e cila deklaroi: Unë jam anëtare e komisioni vlerësues, farmaciste e klinikës dhe vlerësimin kemi bërë sipas dosjes së tenderit.
Lista esenciale që ekziston prej vitit 2010.Ankesa e OE është njëherë se nuk kemi vlerësuar dozë në vëllim, dhe njëherë se kemi vlerësuar një kompani Kineze. Institucioni merr përgjegjësinë se a është bari Kinez i mirë apo jo, dhe vlerësimi ynë ka të bëjë me dozën që kemi vlerësuar. Kriter ka qenë autorizim marketingu për produktin që kompania e ka sjell. Ne kemi vlerësuar se doza për njësi është vlerësuar sipas punës dhe përvojës që kam 7 vite privat dhe katër vite përvojë në QKU, dhe asnjë here nuk koordinohet terapi me 2000 njësi apo 2500 njësi. Dëshmitë përpos që janë lëshuar nga klinikat më të mëdha nga QKU ku bëhen intervenimet më të mëdha, mund të jenë provë edhe historitë dhe listat se çfarë doze koordinohet në QKUK.

Në tenderin është vlerësuar me 2000 njësi me 0.2, ku çdo pacient është shpuar 2 deri në tri here.

Ndërsa sasia e planifikuar për 3 muaj është shpenzuar për një muaj e gjysmë pasi është kërkuar çdo here dy ampula. Ne kemi bërë vlerësimin sipas kërkesave të dosjes dhe kjo është rezultati që kemi. Nuk mundet që prodhuesi të jetë më i lirë në treg mirëpo kemi të bëjmë me dozën.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti teknik z.Hoti deklaroj: Sipas shkresave të lëndës dhe analizimit të saj kemi ardh deri te shqyrtimi i lëndës në të cilën jemi pajtuar për dozën e ofruar nga OE fitues sikurse është apo i përshtat listës esenciale të barnave pranë MSH-së.

Në bazë të ankesës së OE pretendimet se i plotëson kriteret te përqendrimi dhe vëllimi nuk qëndrojnë, duke e ditur se lista esenciale ka kërkuar një përqendrim apo njësi të caktuar duke filluar prej 2000 deri 6000 njësi, me vëllim 0.4 ml.

OE ankues Medical Group ka ofruar Heparinë 2500 njësi për 0.2ml.

Ne si ekspert teknik në bazë të analizave dhe të dhënave shkencore vërtetojmë se përqendrimi i substancës heparinë me njësi 4000 IU, e tretur në 0.4ml është pothuajse dy here më e madhe se OE ankues. Sipas shqyrtimit të ankesës tek supozimet të një prodhuesi apo prodhuesi tjetër, ne bazohemi në bazë të Autorizim marketingut të lëshuara nga agjencioni për produkte medicinale apo AKPM në republikën e Kosovës.

Sipas analizave është vërtetuar se në klinikat përkatëse është e nevojshme të jetë prezente heparinë 4000 njësi, 6000 njësi, e në rate tjera deri në 8000 njësi. Në qoftë se trajtojmë me njësi më të vogla atëherë duhet kemi parasysh pasojat anësore që mund të shkaktohen si janë, injektimet e tepruara, të cilat janë përshkruar në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE "Medical Group" z.Ramaj deklaroj: Në mendimin përfundimtar eksperti ka thënë se nuk janë respektuar dispozitat e LPP, çka ka pas shkelje do donim të dimë. Ndërsa për ekspertin duam të sqarojmë doza ofruar prej 2500 njësi ndërkombëtare a është në

përputhje me dosjen e tenderit ku është kërkuar prej 2000 deri në 6000 njësi. Sipas ekspertit dhe përfaqësuesit e AK del se doza duhet të jetë 4000 njësi saktë, dhe jo 2000 deri 6000 njësi. Gjitha palët e konstatuar një fakt të thjesht, me këtë specifikacion teknik çdo here të listës esenciale gjitha vitet e fundit është furnizuar me 0.2 ml dhe ka qenë e përgjegjshme. Problemin e tregoj në prezantim farmacistja e cila thotë unë preferoj volumin 0.4ml dhe i shpall gjithë OE të papërgjegjshëm. Problemi është se AK kanë shpall fituesin ende pa u shikuar ofertat. Autorizim marketingu i kompanisë Kineze nuk i ka njësitë ndërkombëtare siç i kërkon dosja tenderit. Produkti me njësi miligram për mililitra, që është sistem shumë më i vjetër.

MSH ja ka konvertuar sistemin e vjetër në njësi ndërkombëtare, dhe aplikon tani njëjtën logjikë miligram për mililitra. Me respekt kërkojmë nga paneli shqyrtues që lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues z.Basha deklaroj: Ky ka qenë lëshim teknik dhe ai term nuk duhet të jetë aty.

Në përgjigje eksperti teknik z.Hoti deklaroj: Sipas kërkesës së dosjes së listës esenciale kërkohet 2000 njësi deri 6000 njësi 0.4ml, ndërsa në rastin konkret përmendet doza në mënyrë që të anashkalohet vëllimi.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK –MSH z.Bajraktari deklaroj: Kërkojmë të mbetet në fuqi vendimi i AK-së dhe të refuzohet ankesa e OE ankues.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se Autoriteti Kontraktues Ministria e Shëndetësisë e ka eliminuar pa të drejtë OE ankues Medical Group me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kërkesën e FDT-së ku është kërkuar doza 2000 IU – 6000 IU. Paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik ankues e ka plotësuar këtë kërkesë për faktin se ka ofruar dozë 2500 IU, pra brenda parametrave të kërkuar. Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe kriterin kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, siç parashihet në nenin 60 të LPP-së.

Sa i përket kërkesës së AK-së në lidhje me kërkesën për lot 24 OE ankues ka ofertuar brenda njësive të kërkuara në këtë Lot, ndërsa sa i përket militrave ajo është vetëm sasi e cila injektohet, pasi që edhe kontrata ekzistuese lidhur me këtë produkt ka qenë e nënshkruar dhe është bërë furnizimi me sasi prej dy mililitra e jo me 4 mililitra siç ka qenë dhe siç është tani kërkesë e AK-së, këtë fakt e ka pranuar edhe vetë përfaqësuesi i AK-së në seancën dëgjimore, ku ka theksuar se ne e kemi lejuar që të ofertohet me 2 mililitra pas pyetjes së bërë nga njëri prej operatorëve ekonomik. Pra edhe me këtë fakt shihet qartë që sasia në këtë rast prej 2 apo 4 ml nuk ka ndonjë rëndësi dhe peshë të veçantë sidomos

kur e kem parasysh ekonomicitetin dhe efikasitetin, prandaj kjo mund të konsiderohet edhe devijim i vogël konform nenit 59 paragrafi 4 pika ii.

Paneli shqyrtues konstaton se në këtë aktivitet të prokurimit nga autoriteti kontraktues nuk është respektuar edhe neni 1 dhe 6 i LPP-së pasi që qëllimi i ligjit të prokurimit publik është që të sigurohet mënyra më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë ndërsa në nenin 6 parashihet që "*Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit*", pasi që operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim më të shtrenjtë prej 627 mijë euro se sa OE ankues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK "Ministria e Shëndetësisë"

1x1 OE "Medical Group"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.